



KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359
Web: www.kolegjidardania.com

EKSTRAKT NGA DOKUMENTI RAPORT I REFLEKTIMEVE TË PUNËDHËNËSVE PËR TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR DHE CILËSINË E PROGRAMEVE TË KOLEGJIT DARDANIA

GJETJET NGA PYETËSORI

Nga anketimi dhe intervistimi rezulton se ka ndryshime të dukshme në punësimin e të diplomuarve në bazë të gjinisë, të sektorëve të punësimit dhe ato ndryshime shprehen suksesivisht duke u rritur nga periudha 2019/2020, me periudhën 2020/2021, pastaj 2021/2022 dhe relativisht shumë në periudhën 2023/2024.

Ngritje progresive hetohet edhe në opinionet e punëdhënësve për aftësitë dhe shkathtësitë që të diplomuarit tregojn në vendin e tyre të punës. Kur mesatarisht 64.83% e të anketuarve shprehen se të diplomuarit në Kolegjin Dardania janë plotësisht të kënaqur me punën e të diplomuarve tanë në institucionet e tyre, 25% e tyre janë relativisht të kënaqur dhe 10.16% janë të kënaqur mesatarisht.

Në pyetjen e dytë lidhur me aftësitë e të diplomuarve që ti kryejnë detyrat në vendin e punës, 62% e të anketuarve dhe të intervistuarve janë plotësisht të kënaqur, 25.83% janë relativisht shumë të kënaqur, ndërsa 10.5% e tyre deklarojnë se janë mesatarisht të kënaqur me punët e tyre.

Në pyetjen e tretë se të diplomuarit janë të gatshëm të bashkëpunojnë në punën ekipore 68.21% e tyre konsiderojnë se janë të përgatitur plotësisht, 21.62% relativisht shumë dhe 10.16% konsiderojnë se janë mesatarisht të përgatitur për bashkëpunim në punën ekipore.

Ndërkaq në pyetjen e katërt, A i posedojnë aftësitë e nevojshme të diplomuarit për vendin dhe pozitën ku punojnë? Punëdhënësit e anketur dhe të intervistuar konsiderojnë se 67.16% e tyre janë plotësisht të gatshëm të kontribuojnë në vendin e tyre të punës, 21.5% e tyre konsiderojnë se janë

relativisht shumë të përgatitur për vendin e tyre të punës dhe vetëm 11.33% e tyre konsiderojnë se janë të përgatitur se janë mesatarisht të përgatitur për vendin e punës.

Nga anketimi dhe intervistimi i punëdhënësve, rezultojnë përfundimet si në vijim:

- ❖ Programet studimore i kanë aftësuar të diplomuarit me dituri, shkathtësi dhe aftësi të mjaftueshme për vendin e punës;
- ❖ Në programet studimore ofrohen përmbajtje për zhvillimin e potencialeve të nevojshme për të kryer me sukses obligimet e tyre të punës;
- ❖ Programet studimore që ofron Kolegji Dardania janë në harmoni me nevojat e tregut të punës dhe iu mundësojnë të diplomuarve punësim të sigurt;
- ❖ Kurset e studimit nëpër programe studimore janë në funksion të përmbushjes të nevojave të studentëve për bashkëpunim dhe punë ekipore;
- ❖ Lëndët obligative dhe zgjedhore korrespondojnë me profesionet e përcaktuara të përshtatshme për aftësimin e shumëanshëm të tyre;
- ❖ Të anketuarit dhe të intervistuarit theksojnë nevojën e bashkëpunimit të vazhdueshëm me Kolegjin;
- ❖ Të intervistuarit dhe të anketuarit konsiderojnë se puna praktike dhe ajo vullnetare para shërbimit i ka mundësuar studentëve të jenë sa më bashkëpunues dhe të arrinë të kryejnë detyrat në ekip;
- ❖ Punëdhënësit e intervistuar konsiderojnë se Kolegji duhet të organizojë forma të ndryshme organizative të aftësimin në shërbim si: trajnime, punëtori profesionale dhe takime pr shëmbim përvojash;
- ❖ Punëdhënësit konsiderojnë se të diplomuarit disponojnë me dituri dhe shkathtësi të nevojshme për përpilimin dhe reliaizmin e projekteve që lidhen me profesionin e tyre;
- ❖ Studentët disponojnë shkathtësi të kënaqshme për hulumtime në veprim.

Zyrtarët e anketuar dhe të intervistuar e vlerësojnë si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me Kolegjin Dardania, i cili realizohet përmes Zyrës për Zhvillim të Karrierës dhe Zyrës për Sigurimin e Cilësisë. Kontaktet e rregullta kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit dhe në shkëmbimin e informacioneve në fusha të ndryshme me interes të përbashkët. Përvojat e të diplomuarve që tashmë janë të punësuar shërbejnë si burim i vlefshëm informacioni dhe mbështetjeje për studentët aktualë të institucionit.

REKOMANDIMET

Përfundimet e mësipërme të anketimit dhe intervistimit kanë mundësuar identifikimin e aspekteve për ngritjen e cilësisë të programeve studimore si dhe të shërbimeve që ofron kolegji, me qëllim që si institucion privat i arsimit të lartë të arsimojë kuadro cilësore për bizneset dhe tregun e punës. Gjetjet e ofruara ndihmojnë për ngritjen e cilësisë së veprimtarisë së gjithëmbarshme (dijes akademike, aftësimi praktik dhe përgatitjes për hulumtim), si vijon:

- ❖ Të vazhdohet puna e përbashkët për monitorimin dhe vlerësimin e programeve studimore, veprimtarisë akademike, punës praktike dhe shërbimeve para shërbimit;
- ❖ Të integrohen të dhënat mbi performancën e studentëve të diplomuar dhe të punësuar, të siguruar nga punëdhënësit si mekanizma të jashtëm të sigurimit të cilësisë, dhe të shfrytëzohen informatat e tyre për të plotësuar gjetjet nga sistemi i vlerësimit të brendshëm, me qëllim që të gjeturat të jenë të qëndrueshme;
- ❖ Të fuqizohet më tej puna e përbashkët për vlerësimin e performances së të diplomuarve në kolegji;
- ❖ Të vazhdohet azhurnimi dhe bashkëkohësimi i programeve ekzistuese, duke përfshirë më shumë aspekte të aftësimi praktik për studentët para shërbimit;
- ❖ Të vazhdohet puna për zhvillimin e programeve të reja, të bazuara në nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me nivelet 6 dhe 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;
- ❖ Të kërkohen më shpesh reflektimet e të punësuarve për nevojat e aftësimi të tyre në shërbim;
- ❖ Të aplikohet një kuadër strategjik gjithëpërfshirës për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe të zyrtarëve tjerë për mbështetjen e vlerësimit të performancës së studentëve të diplomuar;
- ❖ Të forcohen lidhjet ndërmjet kolegjit dhe tregut të punës, duke përfshirë analizën e nevojave për aftësim në tregun e punës, si dhe sigurimin dhe përcjelljen e informacioneve të nevojshme për planifikim strategjik dhe menaxhimin e punës në institucion;
- ❖ Të mundësohet shtimi i një moduli/kursi për sistemin e menaxhimit të punës së institucioneve sipas profilit të studimeve, bie fjala: menaxhimi i punës në institucionet për Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale; etj.

- ❖ Të nxiten dhe të hartohen politika stimuluese për identifikimin e nevojave të tregut të punës, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik, me qëllim diversifikimin e formave të aftësimit dhe ngritjen e kuadrove të reja profesionale.